



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 29.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **22.04.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik NTP. Nini-Pharm (Flurim Nebija B.I), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Barna nga LE" Lot 28 (Enteral solution)** me Nr. të Prok: **206-24-540-1-1-1** nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik NTP. **Nini-Pharm (Flurim Nebija B.I)**. e dt. 22.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Barna nga LE" Lot 28** me Nr. të Prok: **206-24-540-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 19.04.2024.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 19.04.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik NTP. **Nini-Pharm (Flurim Nebija B.I)**. me datë 22.04.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Barna nga LE" Lot 28 (Enteral solution)**, me Nr. të Prok: **206-24-540-1-1-1**. AK-MSh, me datë 29.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Nuk është specifikuar ndonjë dispozite e shkelur nga AK-MSh.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Sipas dosjes së tenderit, kërkohej në pikën 9.1 & 9.2 Autorizim nga kompania prodhuese për pjesëmarrje në tender.

Ky autorizim duhet të përmbajë:

1. Numrin e prokurimit
2. Numrin intern

3. Emrin dhe Lotin te produktit per te cilin po autorizohemi

4. Te dhenat mbi prodhuesin

5. Email dhe webfaqe per qellime verikimi

Ne asnje rast nuk kerkohet te shenohet sasia e produktit per te cilin po autorizohemi, sepse Autoriteti kontraktues ne baze te ligjeve ne fuqi mund te porosise +/- 30% nga sasia e planifikuar ne tender. Prandaj, ne autorizimin e derguar, prodhuesi ka shenuar nje vlere te perafert me sasine totale nga dosja e tenderit. Mirepo, pas vendimit te autoritetit kontraktues, prodhuesi ka derguar nje deklarate shtese, ku e ceke se mund te na furnizoje me sasine e kerkuar prej 27,936 cope, duke shtuar edhe sasine prej 130% nga vlere totale ne DT.

Prandaj, kerkojme rishqyrtimin e vendimit te autoritetit kontraktues, pasi qe anulimi i ofertes tone eshte bere per nje kriter i cili nuk kerkohet ne dosjen e tenderit dhe kemi oferten me te lire te ofertuar. Ne kete menyre autoriteti kontraktues do te kursente mjete materiale ngase oferta jone eshte me e mira.

Dëmet materiale

Për momentin, vetëm sigurimi i tenderit

Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Pretendimin e juaj ankimor e konsiderojme te pa bazuar, duke marre parasysh se ne oferten tuaj keni ofertuar me autorizim nga prodhuesi per sasine e kufizuar 27,000 njesi, nderkohe qe sasia e parapare ne tender ka qene 27,936.

Ne letrën e dërguar me ankese për amandamentimin e autorizimit, afati i autorizimit te amandamentuar është me kufizim deri me 31.05.2024 ndërkohe qe aktiviteti është për furnizim 24 muaj.

Shih paragrafin nga amandamenti i autorizimit:

This amendment of the letter of authorization issued on the 11th of March 2024 shall be valid until 31st of May 2024.

Sa i përket pretendimit për dëmtim te sigurimit te tenderit, ne këtë aktivitet nuk është kërkuar sigurimi i tenderit, andaj nuk mund te konsiderohet si dëmtim sigurimi i tenderit siç është pretenduar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit